



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 13 shtator 2023
Nr. ref.: Nr. ref.: VMP 2265/23

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO177/23

parashtrues

Komuna e Prizrenit

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin
dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar, dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilën para Gjykatës e përfaqëson Faton Fetahu, avokat, sipas autorizimit të dhënë nga Kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj.

Akti i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit të kontestuar, përkitazi me të cilin parashtruesi i kërkesës, bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, pretendon se cenon përgjegjësitë komunale ose zvogëlon të hyrat e komunës në kundërshtim me garancitë kushtetuese të përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafët 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 2, 3 dhe 5 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, duke pezulluar në tërësi zbatimin e *“nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme deri në vendosjen meritore për kërkesën e parashtruar.”*
5. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon mbajtjen e seancës dëgjimore për të sqaruar çështjet që ndërlidhen me nenin 5 të Ligjit të kontestuar.

Baza juridike

6. Kërkesa është parashtruar bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 39 (Seanca dëgjimore), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 71 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 25 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 31 gusht 2023, përmes Vendimit NR.GJRKKO177/23, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
9. Më 31 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata, për regjistrimin e kërkesës, njoftoi: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (iii) Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit), të cilit i'u kërkuar që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; (iv) Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; (v) Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal së cilës i

kërkoj që kopjen e kërkesës ta shpërndajë te të gjithë kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës; dhe (vi) Avokatin e Popullit. Gjykata i njoftoi palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, deri më 26 shtator 2023.

10. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoj nga ai që më së largu deri më 26 shtator 2023 të dorëzoj në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me Ligjin e kontestuar.
11. Më 1 shtator 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e Gjyqtarit raportues përkitazi me vendimin për masën e përkohshme. Po të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi për (i) miratimin e kërkesës për masë të përkohshme, në kohëzgjatje deri më 30 nëntor 2023; dhe (ii) pezullimin e zbatimit të nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe zbatimin e vendimeve të nxjerra në bazë të këtij neni deri në afatin e lartcekur.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 27 korrik 2023, Kuvendi, me gjashtëdhjetë e një (61) vota “për” dhe një (1) “abstenim”, miratoi Ligjin e kontestuar.
13. Më 16 gusht 2023, Ligji i kontestuar u shpall në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi po atë ditë, bazuar në nenin 10 (Hyrja në fuqi) që përcakton se i njëjti “*hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtarë të Republikës së Kosovës*”.
14. Neni 5 i Ligjit të kontestuar përcakton si në vijim:

“Neni 5

Pas Kapitulli II të Ligjit bazik, shtohet Kapitulli II/A me tekstin si në vijim:

KAPITULLI II/A

FALJA E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023

Neni 11/A

Pranueshmëria

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli.

Neni 11/B

Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme

1. *Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.*
2. *Vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.*
3. *Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.*

*Neni 11/C
Kufizimi*

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

*Neni 11/Ç
Administrimi*

- 1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.*
- 2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës, bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, sipas të cilave mund të kontestoj para Gjykatës kushtetutshmërinë e ligjeve të Kuvendit ose të akteve të Qeverisë, të cilat, sipas pretendimeve, cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, konteston kushtetutshmërinë e nenit 5 të Ligjit të kontestuar, duke pretenduar që i njëjti (i) cenon përgjegjësitë komunale; dhe (ii) zvogëlon të hyrat e komunës, ndër tjerash, duke argumentuar që çështjet që ndërlidhen me tatimin në pronë e paluajtshme janë kompetenca ekskluzive dhe të plota të komunës dhe si të tilla gëzojnë mbrojtjen përmes garancive kushtetuese të përcaktuara në nenet 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës, respektivisht. Në këtë kontekst, para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës, parashtron argumentet përkatëse lidhur me (i) mos përputhshmërinë e nenit 5 të Ligjit të kontestuar me nenet 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës; (ii) kërkesën për masë të përkohshme; dhe (iii) mbajtjen e seancës dëgjimore, dhe të cilat do të përmbledhjen në vijim.

(i) lidhur me mospërputhshmërinë e Ligji të kontestuar me Kushtetutën

16. Parashtruesi i kësaj kërkesë para Gjykatës pretendon që neni 5 i Ligjit të kontestuar cenon përgjegjësitë komunale ose zvogëlon të hyrat e komunës në kundërshtim me garancitë e përcaktuara përkitazi me vetëqeverisjen lokale sipas paragrafit 2 të nenit 12, paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 123 dhe paragrafëve 2, 3 dhe 5 të nenit 124 të Kushtetutës.
17. Parashtruesi i kërkesës, konteston kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar vetëm për sa i përket përmbajtës së tij, përkatësisht nenit 5 të të njëjtit, që përcakton kushtet dhe procedurën për faljen e shumës deri në njëqind (100) euro të tatimit në pronë për paluajtshme për vitin 2023. Sipas parashtruesit të kërkesës, neni 5 i Ligjit të kontestuar, përcakton obligim për komunat, përkatësisht Kuvendet Komunale, që të marrin vendim për faljen e tatimit në pronë të paluajtshme për vitin 2023, përkundër faktit që çështja e tatimit në pronë të paluajtshme është kompetencë ekskluzive e komunës dhe të hyrat nga tatimi në pronë janë të hyra vetanake të komunës, duke cenuar kështu kompetencat dhe duke zvogëluar të hyrat komunale, në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se neni 5 i Ligjit të kontestuar, ka “*vështirësuar, bllokuar e pamundësuar zbatimin e buxhetit të planifikuar e të miratuar paraprakisht me ligjin në fuqi për ndarjet buxhetore për vitin 2023 [...] pasi humbjet financiare nga efekti ligjor i nenit të kontestuar janë jashtëzakonisht të larta*”. Në këtë kontekst parashtruesi i kërkesës, i referohet shkresës së 24 gushtit 2023 të Asociacionit të Komunave të Kosovës, sipas të cilës, ndikimi

financiar në nivelin lokal si rezultat i zbatimit të nenit 5 të Ligjit të kontestuar mund të rezultojë në shumën prej 27,377,896 milion euro, ndërsa për parashtruesin e kërkesës mund të rezultojë në shumën prej 3,000.00 milion euro.

18. Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës thekson që bazuar në (i) nenet 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës; (ii) Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale; (iii) Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe ligjet tjera të aplikueshme, komunave, u garantohet një autonomi dhe pavarësi, ndër tjerash, në kontekst të menaxhimit financiar, përkritazi me (i) të hyrat vetanake të komunave; (ii) grantet e Qeverisë; dhe (iii) të hyrat tjera, dhe se kategoria e tatimit të pronës së paluajtshme është kompetencë vetanake e komunave dhe se të hyrat e mbledhura nga tatimi në pronën paluajtshme shfrytëzohen nga komuna. Parashtruesi i kërkesës, më tej dhe ndër tjerash, pretendon se, duke qene se e hyra kryesore vetanake e komunës është tatimi në pronë të paluajtshme, kjo e hyrë, inkasohet, grumbullohet, administrohet e shpenzohet vetëm për qëllim të planifikuar dhe të vetë përcaktuar të komunës, dhe jo duke zbatuar një ligj të Kuvendit të Kosovës, si në rrethanat e rastit konkret, i cili në thelb, jo vetëm që cenon përgjegjësitë komunale dhe shpenzimet e këtyre të ardhurave, por edhe i zvogëlon të njëjtat dhe si pasojë shkel autonominë financiare të komunës.
19. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës, përveç neneve relevante të Kushtetutës që rregullojnë çështjen e vetëqeverisjes lokale siç janë neni 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës, i referohet edhe neneve 2 (Themeli kushtetues e ligjor i autonomisë vendore) dhe 9 (Burimet financiare të bashkësive vendore) të Kartës Evropiane për Qeverisje Lokale si dhe, dispozitave relevante të ligjeve në fuqi, përfshirë (i) neneve 15 (Parimi i subsidiaritetit), 16 (Kompetencat komunale) dhe 17 (Kompetencat vetanake) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale; (ii) neneve 2 (Pavarësia Financiare e Komunave), 3 (Kufizimet në Pavarësinë Financiare të Komunave), 4 (Kompetencat Vetanake), 7 (Burimet Financiare Komunale), 8 (Kategoritë e të Hyrave Vetanake) dhe 9 (Taksa në Pronën e Paluajtshme) të Ligjit Nr. 03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal; dhe (iii) nenet 1 (Qëllimi), 3 (Përkufizimet) dhe 4 (Të hyrat nga tatimi në pronën e paluajtshme) të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
20. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kërkon që kjo e fundit, neni 5 të Ligjit të kontestuar, (i) të shpallë në kundërshtim me nenet 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës, dhe për pasojë, (ii) të njëjtin të shpallë të pavlefshëm dhe të shfuqizojë.
(ii) lidhur me kërkesën për masë të përkohshme
21. Sa i përket kërkesës për vendosje të masës së përkohshme, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata, të pezulloj në tërësi zbatimin e *“nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme deri në vendosjen meritorë për kërkesën e parashtruar”*.
22. Kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme parashtruesi i kërkesës e arsyeton me faktin se (i) Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare, përkatësisht më 16 gusht 2023; (ii) neni 5 i Ligjit të kontestuar, duke shtuar Kapitullin II/A në Ligjin për Tatimin në Pronë, përcakton detyrimin që çdo komunë më së largu tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e Ligjit të kontestuar të merr vendim për faljen e tatimit në pronë të paluajtshme; andaj sipas tij (iii) zbatimi i të njëjtit, i shkakton pasoja të mëdha financiare parashtruesit të kërkesës dhe komunave të tjera, përkatësisht nivelit të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.
23. Lidhur me këtë, sipas parashtruesit të kërkesës, neni 5 i Ligjit të kontestuar, në *“pikëpamje të pasojave juridike që ka shkaktuar dhe do të shkaktojë në të ardhmen, paraqet rastin më kuptimplotë kur një vendim për masë të përkohshme është në*

interesin publik dhe eviton dëme të pakthyeshme e të pariparueshme për sa i përket shkeljes së garancive kushtetuese të parimeve të qeverisë demokratike të nivelit lokal dhe kompetencave vetanake në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.” Parashtruesi i kërkesë gjithashtu saktëson që zbatimi i nenit 5 të Ligjit të kontestuar në nivelin e komunal, ndër tjerash, (i) rezulton në pasoja konkrete në ushtrimin efektiv të kompetencave të pushtetit lokal në mbarë Republikën e Kosovës; dhe (ii) cenon rëndë rendin kushtetues dhe vlerave mbi të cilat qëndron Republika e Kosovës në kuptim të pavarësisë, organizimit dhe funksionimit të pushtetit lokal në raport me nivelin qendrorë.

24. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës thekson se *“jemi në situatë tepër të vështirë ligjore. Nga njëra anë, të zbatojmë nenin 5 të këtij ligji (nën presion e afatit 30 ditor, i cili ka filluar të rrjedhë më 16 gusht 2023) dhe në këtë mënyrë të vendosim këshilltarët komunal përballë situatës kur ata nuk mund të veprojnë dhe të vendosin të lirë, si zyrtarë të zgjedhur – që të votojnë me vullnetin e tyre të lirë, por të votojnë “pro” për shkak të politizimit të këtij rregullimi ligjor dhe efektit financiar dhe politik që implikon; apo nga ana tjetër, të zgjedhin “shkeljen” e këtij ligji dhe marrjen e pasojave juridike bashkë me të, për të mos e miratuar një vendim të tillë në kuvendin komunal dhe për të marrë të gjitha pasojat juridike, penale financiare e politike për “moszbatimin e ligjit” në një çështje themelore të kompetencave vetanake të komunës për të cilën as nuk jemi konsultuar, as nuk kemi planifikuar buxhetin as nuk jemi subvencionuar nga pushteti qendror që ka “deleguar” këtë detyrim, por jemi cenuar në menaxhimin e të hyrave vetanake, siç të njëjtat janë zvogëluar për mbi 3 milion euro”.*
25. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata, që pa paragjykim ndaj pranueshmërisë ose meritave të kërkesës, të miratojë kërkesën për masë të përkohshme përkitazi me nenin 5 të Ligjit të kontestuar deri në vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës.

Vlerësimi përkitazi me masën e përkohshme

26. Me qëllim të vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata së pari rikujton bazën kushtetuese mbi të cilën kërkesa përkatëse është dorëzuar në Gjykatë.
27. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*
28. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë; të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.”
29. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcakton:

“[...]

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi

i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

[...].”

30. Më tej, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit, i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.”

31. Gjykata po ashtu rikujton rregullin 44 (Kërkesa për masë të përkohshme), paragrafin (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Në qfarëdo kohe, përderisa Gjykata të mos ketë vendosur lidhur me një kërkesë, çdo palë mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme lidhur me çështjen që është objekt i procedurës para saj, siç përcaktohet me nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit.

[...]

(3) Kërkesa për masë të përkohshme duhet të paraqitet me shkrim, duhet të përshkruajë faktet përkitazi me kërkesën, argumentet për të mbështetur kërkesën, masat e kërkuara dhe pasojat e parashikuara në mënyrë të arsyeshme nëse kërkesa miratohet. Pala që kërkon masën e përkohshme mund t'i bashkëngjisë kërkesës edhe dokumente dhe dëshmi të tjera që janë të rëndësishme dhe që e mbështesin kërkesën.

[...]”

32. Në fund, Gjykata rikujton rregullin 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme), të Rregullores së punës, që specifikon:

(1) Nëse gjyqtari/ja raportues/e i/e caktuar për kërkesën bazë, e vlerëson të nevojshme të trajtojë kërkesën për masë të përkohshme ndaras nga kërkesa bazë, atëherë ai/ajo përgatitë një raport të veçantë lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, brenda një afati të arsyeshëm.

(2) [...]

(3) [...]

(4) Kolegji shqyrtues rekomandon miratimin e tërësishëm ose të pjesshëm të kërkesës për masë të përkohshme nëse konstaton se:

(a) evitohen rreziqe ose dëme të pariparueshme nëse lejohet masa e përkohshme; ose

(b) vendosja e masës së përkohshme është në interes publik.

(5) [...]

33. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata rikujton që parashtuesi i kërkesës konteston nenin 5 të Ligjit të kontestuar, duke pretenduar se i njëjti cenon përgjegjësitë dhe zvogëlon të hyrat e tij në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 12, paragrafët 1 dhe 3 të nenit 123 dhe paragrafët 2, 3 dhe 5 të nenit 124 të Kushtetutës, dhe të cilat, ndër tjerash, përcaktojnë që (i) veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale; (ii) themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre rregullohen me ligj; (iii) komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin dhe autoriteti

- shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit; dhe (iv) komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin. Gjykata gjithashtu rikujton që kërkesa është dorëzuar nga Komuna e Prizrenit, bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, brenda një (1) viti pa hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore, siç parashihet në nenit 41 të Ligjit.
34. Ndërsa sa i përket kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkesën për pezullim të zbatimit të nenit 5 të Ligjit të kontestuar, ndër të tjerash, e mbështetë në faktin se (i) i njëjti ka hyrë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare, përkatësisht më 16 gusht 2023 dhe përcakton detyrimin që çdo komunë më së largu tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e Ligjit të kontestuar të merr vendim për faljen e tatimit në pronë të paluajtshme, duke cenuar përgjegjësitë e komunës në kontekst të kompetencave vetanake dhe duke zvogëluar të hyrat e tij; (ii) zbatimi i të njëjtit i shkakton pasoja të mëdha financiare parashtruesit së kërkesës dhe komunave të tjera në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore për menaxhimin e pavarur të të hyrave vetanake në nivel komunal; përderisa gjithashtu (iii) vendos këshilltarët e kuvendin komunal, si përfaqësues të zgjedhur nga qytetarët e Republikës së Kosovës, përballë detyrimit që të votojnë për faljen e tatimit në pronë të paluajtshme; si dhe (iv) mund të krijoj pasoja juridike për komunën në rast të mosndërmarrjes së veprimeve të përcaktuara me nenin 5 të Ligjit të kontestuar, brenda afatit të caktuar tridhjetë (30) ditor, përkatësisht vendimmarrjes për faljen e tatimit në pronë të paluajtshme.
 35. Lidhur me këtë, bazuar në dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, masa e përkohshme mund të kërkohej nga palët (i) *“lidhur me çështjen që është objekt i procedurës para saj [Gjykatës]”*; me kushtin që pala që kërkon masë të përkohshme të arrijë të dëshmojë se (ii) masa e përkohshme është e nevojshme *“për tu evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme”*; ose që masa e përkohshme është në *“interes publik.”*
 36. Në këtë drejtim, dhe në vlerësim të plotësimi të kriterëve të lartcekura, Gjykata rikujton që kërkesa e parashtruesit të kërkesës ka për objekt shqyrtimi nenin 5 të Ligjit të kontestuar, sipas së cilit, (i) çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023, kualifikohet për faljen e tatimit; (ii) shumat e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro; (iii) vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji; (iv) në rast që tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shumat e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese; (v) falja tatimore zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023; dhe (vi) zbatimi i kësaj dispozite mbetet në përgjegjësinë e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të asaj komune dhe Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e kësaj dispozite.
 37. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se pretendimet dhe faktet e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës, ngritin çështje të nivelit kushtetues që, ndër tjerash, ndërlidhen me ushtrimin e kompetencave vetanake të komunave si dhe të drejtën e tyre për të vendosur, mbledhur dhe shpenzuar të hyrat e veta sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Për më tepër, zbatimi i nenit 5 i Ligjit të kontestuar brenda afateve të përcaktuara në të, përkatësisht tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi Ligjit të kontestuar (i) në njërën anë mund të cenon ushtrimin e kompetencave komunale në ndërlidhje me të hyrat nga tatimi në pronën e paluajtshme për vitin 2023; ndërsa (ii) në anën tjetër, mund të afektojë edhe të drejtat dhe detyrimet

e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023.

38. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata vlerëson se, në rrethanat e rastit konkret, pezullimi i efekteve të nenit 5 të Ligjit të kontestuar, mund të *“eviton rreziqe apo dëme të pariparueshme”* që ndërlidhen me garancitë kushtetuese përkitazi me organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale si pasojë e ndërmarrjes së veprimeve nga pushteti lokal sipas përcaktimeve dhe afateve të saktësuara në nenin 5 të Ligjit të kontestuar. Për më tepër, vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit të kontestuar, para zbatimi të tij, është në *“interesin publik”*, sepse i shërben sigurisë juridike në ndërlidhje me pasojat juridike të Ligjit të kontestuar lidhur me (i) ushtrimin e përgjegjësiwe komunale dhe menaxhimit të hyrave të komunës nga tatimit në pronë të paluajtshme; dhe (ii) të drejtat dhe detyrimet përkitazi me tatimin në pronë të paluajtshme për vitin 2023 për tatimpaguesit, përkatësisht qytetarët e Republikës së Kosovës.
39. Për më tepër, vendosja e masës së përkohshme ndaj nenit 5 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht pezullimi i efekteve të tij deri në vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës, mundëson evitim të cenimit të përgjegjësiwe komunale dhe zvogëlimit të të hyrave përkatëse komunale, në rast që Gjykata përmes vendimmarrjes përfundimtare konstaton që neni i lartcekur nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën. Në të kundërtën, përkatësisht nëse Gjykata, pas vlerësimit dhe vendimmarrjes përfundimtare të saj, konstaton që neni i lartcekur është në përputhshmëri me Kushtetutën, komunat do të mund të zbatojnë nenin 5 të Ligjit të kontestuar dhe qytetarët edhe më tej do të mund të përfitojnë nga falja e tatimit në pronë të paluajtshme sipas vlerësimeve dhe vendimeve përkatëse të kuvendeve komunale, ndërsa shuma e falur për vitin tatimor 2023, do të llogaritet si paradhënie për vitet pasuese sipas vet përcaktimeve të nenit të lartcekur.
40. Për pasojë, Gjykata, në dritën e sqarimeve të lartcekura, vlerëson që kërkesa e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme ndaj efekteve të nenit 5 të Ligjit të kontestuar, duhet të miratohet, sepse i shërben mundësisë së *“evitimit të rreziqeve ose dëmeve të pariparueshme”* dhe është në *“interes publik”*. Lidhur me këtë, Gjykata gjithashtu sqaron se efektin pezullues deri në vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës i nënshtrohen edhe vendimet e nxjerra nga kuvendet komunale përkatëse në zbatim të nenit 5 të Ligjit të kontestuar. Kjo, ndër tjerash, duke pasur parasysh se vendimet e nxjerra bazuar në nenin i cili është pezulluar nga Gjykata, nuk mund të krijojnë pasojat juridike nëse dispozita ligjore bazuar në të cilin janë nxjerrë, është e pezulluar.
41. Gjykata, në fund rithekson se, miratimi i masës së përkohshme deri më 30 nëntor 2023, nuk paragjykon në asnjë mënyrë pranueshmërinë dhe/ose meritat e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 116 të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 45 të Rregullores së punës, më 1 shtator 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË MIRATOJË kërkesën për masë të përkohshme, në kohëzgjatje deri më 30 nëntor 2023;
- II. TË PEZULLOJË MENJËHERË zbatimin e nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe zbatimin e vendimeve të nxjerra në bazë të këtij neni, në kohëzgjatjen e përcaktuar në pikën I;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. TË KONSTATOJË se ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani